

Nr.regj.37307/11

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE	
CORRUPTION AGENCY	
Lib:	Nr. Prot:
Dip:	B. Prot:
Dip: DPK/DMF	Prot. No: 03-3140/13
Nr. Flet:	Class:
01	02-10-2013
Emri i funksionaris:	Data:
PRISHTINE	

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes, Gjyqtari Blerim Igrishta, me procesmbajtësen Ganimete Hasani-Krasniqi, në lëndën e kundërvajtjes kundër të pandehurit Sherafedin Memxhiu, nga Prishtina, për shkak të kundërvajtjes nga neni 7/1 i sanksionuar me nenin 16 par. 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lart, sipas kërkesës për fillimin e procedurës së kundërvajtjes nga Agjencioni Kundër Korrupsionit me nr.01-4110/11 të datës 26.10.2011, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse përkitazi me kundërvajtjen e lartcekur, më datën 11.07.2013, muar këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit Sherafedin Memxhiu nga Prishtina, konform nenit 198.2 e lidhur me nenin 11 al. 1,2 dhe 3 të Ligjit mbi Kundërvajtje, ngase i pandehuri e ka përmbushur obligimin para se të merret aktvendimi mbi kundërvajtjen.

Shpenzimet të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palës dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencioni Kundër Korrupsionit, me kërkesën nr. 01-4110/11 të datës 26.10.2011, i propozoi gjykatës hapjen e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartcekur, për kundërvajtjen e cekura me lartë.

Në bazë të të dhënave të parashtruara në kërkesë, vlerësimi të provave veç e veç dhe të gjitha së bashku, analizimit të shkresave të lëndës dhe duke marr për bazë edhe Aktvendimin e Gjykatës së Lart për Kundërvajtje në Prishtinë me nr. 1204/12, dhe interpretimit të cilin e ka bërë kolagji i kësaj Gjykatën i përberë nga tre gjyqtar profesionist, në rast të njëjta dhe të ngjashme, Gjyqtari i çështjes merr aktvendim për PERZULLIMIN e procedurës, me konstatimin se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësin për kundërvajtje duke u bazuar në nenin 11 al.1 të LpK-së, i cili sqaron se në rast kur kundërvajtja konsiston në mos përmbushje të obligimit të përcaktuar mund të pezullohet procedura kundërvajtës, nëse kryesi i kundërvajtjes para se të merret aktvendimi mbi kundërvajtje e përmbush obligimin e caktuar, e duke marr parasysh natyrën e kundërvajtjes vetit personale të kryesit dhe rrethanat në të cilën është kryer kundërvajtja, mund të pritet se edhe pa dhënieje të dënimit në të ardhmen nuk do të bëjë kundërvajtje, e po ashtu në al.2 e 3 parashihet se nëse kryesi i kundërvajtjes brenda afatit prej 30 ditësh e përmbush obligimin do të pezullohet procedura kundërvajtës.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 199 të LmK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit Divizioni për Kundërvajtje, në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimit, përmes këtij divizioni.

